



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.08/2017

Prishtinë, më 22 janar 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Albulena Balaj-Halimaj dhe Mytaher Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Gordana Subotic- Melbourne University.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës për vitin 2018;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12, 18 dhe 20 dhjetor 2017, u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2017

Kryetarja, tha se raportin e punës e keni marrë me kohë dhe me siguri edhe e keni analizuar në tërësi.

Për këtë pikë nuk pati debat, dhe më pas, kryetarja konstatoi se Komisioni Funkcional miratoi Raportin e punës për sesionin vjeshtor të vitit 2017.

3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës për vitin 2018

Kryetarja hapi diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Mexhide Mjaku-Topalli, propozoi që kur t'i realizojmë vizitat nëpër njësitë komunale për të drejtat e njeriut, njëkohësisht t'i vizitojmë edhe qendrat për ndihmë juridike falas.

Ajo, po ashtu, shtroi çështjen e vizitave në institucionet private lidhur me monitorimin e shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se tashmë dihet se kemi shkelje të të drejtave të punëtorëve, dhe sipas disa të dhënave që kam, këta nuk gëzojnë asnjë të drejtë. Pra, shumë probleme duhet të trajtohen, sepse kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të njeriut.

Ajo propozoi të ftohet ministri i Punës dhe të shihet se si funksionon Inspektorati i Punës.

Më tej, tha se çështje e rëndësishme që duhet të diskutohet është edhe çështja e barazisë gjinore nëpër komuna, përfaqësimi i gjinisë femërore në organet ekzekutive është jo i kënaqshëm dhe në drejtoritë komunale mezi kanë arritur të zgjidhen një apo dy femra në ekzekutiv, kjo është shqetësuese.

Lirije Kajtazi, tha se me ligj, sektorin privat është i thirrur që ta monitorojë Institucioni i Avokatit të Popullit.

Ajo theksoi se se më së miri është të bëjmë monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe aty iu qasemi edhe këtyre problemeve. Aty i kemi të gjitha institucionet që obligohen, sektorin publik, privat dhe i shohim të gjitha.

Teuta Haxhiu, tha se si hap i parë është mirë të shohim, sa po zbatohen rekomandimet IAP-it për vitin paraprak, sepse shumicën e këtyre temave që u ngritën janë të përfshira në ato rekomandime.

Do të ishte mirë të kërkojmë përgjegjësi edhe nga Inspektorati i Punës.

Mirjeta Kalludra, tha se si komision, nëse kemi mundësi për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve të pakos së të drejtave të njeriut.

Më tej, tha se me plan të punës i kemi dy monitorime të ligjeve dhe mbështeti idenë e mbikëqyrjes së zbatimit edhe të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.

Kryetarja konstatoi se monitorimi i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi të fillojë në muajin shkurt dhe të bëhet paralel me Ligjin për barazi gjinore.

Komisioni debatoi lidhur me Projektligjin për lirinë fetare në Kosovë dhe për dëgjimin publik, që do të mbahet lidhur me këtë projektligj.

Kryetarja konstatoi se më datë 29 janar 2018, në orën 10:00, të thirret dëgjimi publik për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, të ftohen përfaqësuesit e të gjitha bashkësive fetare, Akademia e Shkencave, MASHT, grupet parlamentare, përfaqësuesit e ambasadave, shoqëria civile, deputeti Nait Hasani, përfaqësuesin e komunitetit bektashian në Kosovë, Zyra Ligjore e Kryeministrit etj.

Kryetarja propozoi që të mbahet edhe një mbledhje dhe të diskutohet për mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për persona të zhdukur.

Në lidhje me këtë çështje, deputetja Teuta Haxhiu njoftoi anëtarët e komisionit, se ishte e ftuar në mbledhjen e parë, në kuadër të Qeverisë, bashkë me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe me shoqatat e familjarëve të zhdukur, si dhe të gjithë aktorët tjerë. Po ashtu, prezantoi në emër të komisionit nismën për t'u takuar me Komisionin për Shëndetësi dhe të shihet mundësia se si t'i qasemi ndryshimit të këtij ligji.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga MPMS, ku nga ata ishte sqaruar se draftin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për persona të zhdukur e kanë të gatshëm dhe do ta dërgojnë në Qeveri.

Ky draft-ligj, theksoi ajo, do të rregullojë edhe çështjen e beneficione të kësaj kategorie, kështu që kjo punë mbetet të procedohet përmes Qeverisë.

Në fund, ajo tha se ka propozuar që në takimet e rregullta të nivelit qeveritar, që mbahen në kuadër të Qeverisë, përherë, të jetë i ftuar edhe një anëtar nga komisioni i ynë.

Deputetja Haxhiu, propozoi që sa i përket 27 Prillit- Ditës Kombëtare për Personat e Zhdukur, të gjitha aktivitetet të bashkërendohen me Kuvendin dhe me Qeverinë e Kosovës.

Në fund, ajo propozoi që si komision, zyrtarisht të jenë pjesëmarrës në shënimin e datës së 27 Prillit- Ditës Kombëtare për Personat e Zhdukur, në përkujtimin e viktimave të masakrës në Mejë.

Kryetarja, konstatoi se, meqenëse për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për persona të zhdukur, qenkan paraparë të bëhen hapa nga ana e Qeverisë, atëherë ne mbesim të presim draftin dhe më pas edhe si Komision Funkcional, do të japim kontributin tonë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për persona të zhdukur.

Kryetarja, lidhur me draft-planin e punës, konstatoi se te vizitat në njësitë e të drejtave të njeriut, të shtohen edhe zyrat për ndihme juridike falas dhe do të vizitohen: Prishtina, Mitrovica, Prizreni, Gjakova, dhe ndoshta, edhe ndonjë komunë tjetër, ku e shohim të arsyeshme, në të ardhmen.

Lirije Kajtazi, lidhur me shënimin e 27 Prillit - Ditës Kombëtare për Personat e Zhdukur, propozoi që këtë vit, si Komision Funkcional, të vendosim buqeta lulesh te përmendorja e

personave të zhdukur, që është në oborrin e Kuvendit, dhe më pas, të thirret një konferencë për media dhe të kërkohet zbardhja e fatit të personave të zhdukur, ndërsa aktivitetet tjera t'i bëjmë në bashkërendim me Kuvendin dhe Qeverinë.

Po ashtu, komisioni vendosi që në muajin mars, të mbajë edhe një konferencë rajonale, me temë: Pozita e femrës në rajon. Në këtë konferencë do të ftohen përfaqësuesit nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Bosnjë e Hercegovina dhe Kroacia.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës, kryetarja konstatoi se komisioni, me këto plotësime, miratoi planin e punës për vitin 2018.

4. Të ndryshme

Kryetarja, tha se sa i përket ankesës së Mustafë Prenkut, keni marrë, me e-mail, përgjigjen e Avokatit të Popullit.

Ndërsa, MPMS-së dhe ZQM-së, ju kemi shkruar, por ZQM, ka thënë se nuk është kompetent, dhe këtë kompetencë e ka MPMS, ndërsa MPMS ende nuk ka kthyer përgjigje.

Kryetarja konstatoi se komisioni edhe njëherë t'i drejtohet sekretarit të MPMS-së, me një shkresë për këtë lëndë, për të marrë një përgjigje.

Po ashtu, ajo tha se mbledhja e radhës do të mbahet të mërkurën, më dt.24 janar 2018, për të diskutuar për organizimin e konferencës rajonale.

Mexhide Mjaku-Topalli, e ngriti çështjen e një shkrese që ajo ka pranuar nga personi Nysret Shillova – Organizata “Dëshira”, e cila ka të bëjë me çështjen e personave me aftësi të kufizuara. Ajo tha se është mirë që administrata ta kontaktojë atë person, për të parë kërkesat e tij dhe më pas të shohim se çka mund të ndërmarrim, lidhur me këtë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje

